



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:165316

Datë: 26.03.2021

Numri i dokumentit: 01637758

PKR.nr.269/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I KIRMEVE TË RËNDA me kryetaren e trupit gjykues Lumturije Muhaxheri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores Gylaj Nepola, në lëndën penale kundër të pandehurës E. B. nga, për shkak të veprës penale, Falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 219 par. 2 lidhur me par. 1 të ish KPRK-së, (nr. 04/L-082) , e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP/I.nr.128/20 të dt. 25.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencë të Prokurorit të shtetit Haxhi Sinanaj, të pandehurës Elvire Bardhi, me dt. 18.02.2021, mori dhe me dt.09.03.2021 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura E. B. , e bija e A. B. dhe nënës S. e gjinisë B., e lindur me dt. në, me banim në rr. “ ” nr.35, ka të kryer shkollën e mesme, e martuar, nënë e tre fëmijëve, e pa punë, e gjendjes së dobët ekonomike, nr. personal, me nr. tel:, shqiptare, Shtetase e R. së Kosovës

ËSHTË FAJTORE

Për shkak se:

Me dt.11.06.2017 në, duke keqpërdorur pozitën apo autorizimin e saj lidhur me zgjedhjet ka regjistruar në mënyrë të pasaktë rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore, në atë mënyrë që e pandehura ditën kritike e cila ishte e autorizuar nga KQZ si kryetare e komisionit zgjedhor në vendvotimin me nr 1704X/05R ka shkelur nenin 102 par.2 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, me ç ‘rast ditën kritike në vendvotimin me nr.1704Y/04R që ishte në shkollën fillore “8 Marsi” në Pejë, pikërisht pas numërimit të votave në FRK (Formulari i rezultateve të kandidatëve) në kundërshtim me nenin 102 par.2 të Ligjit NR.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ka regjistruar gabimisht votat e kandidatëve, duke regjistruar 13 vota me pak si dhe 50 vota më shumë, me ç’rast me gjithsejtë 63 vota i ka dëmtuar kandidatët e ndryshëm brenda subjekteve politike për zgjedhjet e përgjithshme.

-Me çka ka kryer veprë penale, “Falsifikim i rezultateve të votimit” nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të ish KPRK-së..

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7,41,42, 49,50,51, 52,73, të KPRK-së dhe nenit 219 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurës i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu që i caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, por që nuk do të ekzekutohet në rast se e pandehura nuk kryen ndonjë veprë të re penale brenda periudhës 1 (një) vjeçare.

E pandehura është obliguar që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësorë gjykatës ti paguaj shumën prej 20€, dhe shumën prej 50€ në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

REFUZOHET propozimi i prokurorisë që konform nenit 66 par.1 të ish KPRK të akuzuarës ti shqiptohet dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të funksionit në administratën publike apo shërbimin publik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Krimeve të Renda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.128/20 të dt.25.11.2020, kundër të pandehurës, E. B. për shkak të veprës penale “Falsifikim i rezultateve të votimit” nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të ish KPRK-së.

Para leximit të aktakuzës e akuzuara është njoftuar me të drejtat e saj procedurale dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP/I.nr.128/20 të dt.25.11.2020 në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se e pandehura e ka kuptuar aktakuzën dhe të drejtat e saj ashtu që i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të pandehurën për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ku e pandehura E. B. ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, i vjen keq, është penduar dhe gjykata ta ketë parasysh se është e gjendjes së dobët ekonomike.

Prokurori ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë pasi që e njëjta është e vullnetshëm dhe është në përputhje me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, propozon që ndaj te njëjtës të shqiptohet dënimi plotësues.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të pandehurës vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të saj, pasi që e njëjta i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka shpall fajtor të pandehurën bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e saj, si dhe bazuar në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, siç janë: Deklarata e të dyshuarës e dhënë në polici më dt.08.07.2020 si dhe në prokurori me dt. 21.10.2020, Libri i votimit, formulari i rezultatit me numër të vendvotimit 1704X/05 R, formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve si dhe nga formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve nga qendra e rinumërimit.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, Gjykata ka vlerësuar faktin se e njëjta kishte sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar, është penduar për veprën penale duke shprehur keqardhje, e njëjta me parë nuk ka ra ndeshë me ligjin, gjendjen e vështirë ekonomike e cila është e pa punë, të gjitha këto rrethana Gjykata i ka pranuar si rrethana favorizuese. Si rrethanë tjetër lehtësuese gjykata e merr faktin se e pandehura në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, gjë që dëshmoi gatishmëri për

bashkëpunim me organin e akuzës dhe me gjykatën, dhe kjo sipas vlerësimit të gjykatës paraqet pendim të sinqertë të saj dhe fillim të procesit të rehabilitimit të pandehurës. Andaj ne prezencën e këtyre rrethanave lehtësuese dhe ne mungese të ndonjë rrethane renduese, Gjykata të pandehurën e gjykoi me dënim si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi me të cilën do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Duke i vlerësuar kështu të gjitha rrethanat e parashikuar me nenin 69 par.1 të KPK-se, Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurës është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të saj dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit, në pengimin e të pandehurës në kryerjen e veprave penale në të ardhmen por, ai do të ndikoj edhe si preventivë gjenerale për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPRK-se .

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së, gjykata e obligoi të pandehurën në paguarjen e shpenzimeve të paushallit gjyqësorë.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par.3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit e obligoj me pagesën në shumën si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata ka refuzuar propozimin e prokurorisë për shqiptimin e dënimit plotësues ndalimi i ushtrimit të funksionit në administratën publike apo shërbimin publik, pasi që vlerësoj se detyra e komisionarit në zgjedhje pushon me mbarimin e zgjedhjeve dhe certifikimin e tyre, e kjo bazuar në nenet 74,75,76 Ligji nr. 03/1-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Dënimi plotësues i propozuar nga prokuroria kryesisht shqiptohet kur kemi të bëjmë me kapitullin e veprave penale kundër detyrës zyrtare (shih komentarin e kodit penale neni 65, ku theksohet se ky dënim plotësues shqiptohet te veprat penale nga neni 422-437).

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në nenin 368 par.2 të KPPK-se, Gjykata palët në procedurë i njoftoi me paralajmërimet që shoqërojnë aktgjykimin.

GJYKATA THEMELORE PEJË Departamenti i Krimeve të Renda
P.nr.269/20 dt.18.02.2021 perpiluar me dt.09.03.2021

Bashkëpunëtorja Profesionale:
Gylaj Nepola

Kryetarja e Trupit Gjyqësor :
Lumturije Muhaxheri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.